



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 04.

Prishtinë, më 23.05.2011

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Rašić, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Rasim Demiri dhe Etem Arifi .

Kurse Munguan: Lirije Kajtazi, Petar Miletic dhe Mufera Sinik

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues nga OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI Shkelzen Lushaku, Kastriot Shala, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Rašić, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**
- 3. Miratimi i Draft planit dhe programit të punës për vitin 2011.**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar 27.04.2011

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.04.2011, pa vërejtje.

3. Miratimi i Draft planit dhe programit të punës për vitin 2011.

Kryesuesi- theksoi se në muajin e kaluar komisioni në bashkëpunim me OSC-ne, ka organizuar një punëtori pune ku janë shqyrtuar të gjitha pikat e Planit dhe programit të punës për vitin 2011, i cili është

gjithëpërfshirës dhe i cili është në harmoni me legjislaturën e Qeverisë. Njëherit është shqyrtuar edhe Plani i veprimit për integritet Evropian.

Pasi nuk kishte propozime tjera Komisioni miratoi Plani dhe programin e veprimit për vitin 2011. Ndërkohë Komisioni në raste të jashtëzakonshme do të veprojë ad hoc.

4. Të ndryshme.

Etem Arifaj- foli lidhur me çështjen e shpërthimit të zjarrit në banesa të komunitetit Rom Egjiptian dhe Ashkali në kampin e Plementinit. Ky problem rrjedh që nga muaji janar të po këtij viti dhe që nga ajo periudhë ky komunitet jetojnë në tenda, ndërsa deri sot nuk ka ndërmarrë asnjë veprim institucionet shtetërore. Gjendja ekonomike për këtë komunitet është alarmante dhe se përpos përkujdesjes kanë nevojë edhe për higjienë dhe medikamente.

Këto raste e imponojnë nevojën për bashkëpunim institucional si në nivelin qendror gjithashtu edhe në atë lokal, me qëllim të realizimit të një koordinimi të mirë të raporteve në relacionin Kuvendi- Qeveria, prandaj presim përgjigje përkatëse.

Ai propozoi që brenda javës, Komisioni duhet të vizitoi pjesëtarët të cilët jetojnë në Plementin..

Albert Kinolli – u ndërlidh me parafolësin se çështja e kampit të Plementinit është e një rëndësie të veçantë të komunitetit Rom, Egjiptian dhe Ashkali, Andaj propozoi që për tejkalimin e kësaj situate Komisioni duhet sa më parë të vizitoi Komunën e Obiliqit. Kërkesa jonë është që të vihen kontakte direkte me Institucionet përkatëse.

Myzejene Salmanaj- në fjalën e saj tha se dihet që fshati i Plementinit është në Komunën e Obiliqit.

Ajo përkrah iniciativën me propozim të Etem Arifit lidhur me gjendjen faktike të komunitetit pakicë të cilët ende jetojnë në tenda.

Në këtë drejtim Komisioni mund të kërkojë informacione nga Komuna e Obiliqit, MKK dhe Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale Nëse nuk marrim përgjigje adekuate atëherë Komisioni do të drejtohet për informacion edhe Ministrisë së pushtetit lokal. Ajo shtoi se Ministrinë përkatëse duhet të japin përgjegjësi para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi- tha se për arsye të situatës së krijuar në komunën e Obiliqit, është ide e mirë që Komisioni të dale në vend të ngjarje. Ai propozoi që të formohet një nën komision i cili do të vizitojë kampin e Plementinit. Për këtë nën komision janë caktuar Sasa Rasic, Etem Arifi dhe Albert Kinolli, të cilën vizitë do të realizojnë brenda javës.

Kryesuesi –konstatoi se Komisioni merr qëndrim se do ta iniciojë këtë çështje në Institucionet përkatëse dhe nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur më 23.05.2011, vendosi që nga resorët kompetente: Ministrina për Komunitete dhe Kthim, Ministria për Qeverisje Lokale Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Kryetari i Komunës së Obiliqit të kërkojë informata për gjendjen faktike të pjesëtarëve të komunitetit RAE, të cilët jetojnë në Plementin, sidomos prej kohës së shpërthimit të zjarrit (datë 31 dhjetor 2010) e deri më sot.

Gjithashtu, në pajtim me kompetencat, të dërgohen deri me datën 26.05.2011 edhe informatat se cilat masa për intervenim janë ndërmarrë me qëllim të eliminimit, kapërcimit dhe zgjidhjes së kësaj gjendje që ka ndodhur si pasojë e shpërthimit të zjarrit.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Saša Rašić